



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 47 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27 / 02 / 2025

VENDIM
Nr.06, date 27 /02 /2025

**NË LIDHJE ME ECURINË E ZBATIMIT TË PROJEKTEVE PËR REHABILITIMIN E DIGAVE
TË FINANCUARA NGA BUXHETI I SHTETIT NË KUADËR TË FONDIT PËR
DIGAT GJATË VITIT 2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) mori në shqyrtim ecurinë e zbatimit të projekteve për rehabilitimin e digave të financuara në kuadër të fondit të digave nga buxheti i shtetit për vitin 2024. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM.

VENDOSI:

- 1- Të kërkoj të gjithë shfrytëzuesve të digave që kanë përfituar nga fondi për digat i financiar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 dhe kanë filluar zbatimin e këtyre projekteve, të dërgojnë informacionet përkatëse pranë KKDM në lidhje me ecurinë e këtyre projekteve, brenda muajit Prill 2025.
- 2- Të kërkoj të gjithë shfrytëzuesve të digave që kanë përfituar nga fondi për digat që në përfundim të punimeve të dorëzojnë projektet e zbatimit sipas faktit dhe dokumentacionin përkatës të aktit të kolaudimit për miratim në KKDM.

Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyre ekzekutive e KKDM të ndjekë procesin e zbatimit të këtij Vendimi dhe të përgatit brenda muajit Maj 2025 një informacion të detajuar në lidhje me plotësimin e detyrave të mësipërme. Për shfrytëzuesit e digave që nuk plotësojnë kërkesat e këtij Vendimi, ITD të propozojë masat që duhet të merren sipas legjislacionit në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI